



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPIAN

Duke u bazuar në dispozitat e nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 2 paragrafi 4 dhe neni 9 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 të datës 28.06.2019 , nenit 20 par.20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të dates 26.09.2008, si dhe Marrëveshjes për Bashkëpunim të lidhur në mes të Komunës së Lipjanit përfaqësuar nga Z. Imri Ahmeti dhe Caritasit Zviceran në Kosovë përfaqësuar nga Znj. Vera Haag Arbenz Drejtoreshë për Kosovë 1Nr-561-31893 të datës 14.05.2019 , 2020 Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 10.09.2021, pas shqytyimit të propozim vendimit të Kryetarit të Komunës miratoi këtë:

## V E N D I M PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE

### Neni 1

I. MIRATOHET, Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej 6,779.00 € (gjashtë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e nëntë euro), për kryerjen e obligimeve që rrjedhin konform dispozitave të Marrëveshjes për Bashkëpunim të lidhur në mes të Komunës së Lipjanit përfaqësuar nga Z. Imri Ahmeti dhe Caritasit Zviceran në Kosovë përfaqësuar nga Znj Vera Haag Arbenz Drejtoreshë për Kosovë, 1Nr-561-31893 të datës 14.05.2019 për zbatimin e Projektit “ Kthimi i qëndrueshëm i personave të riatdhesuar përmes Riintegritimit Socio-Ekonomik” (SUREP) në Komunën e Lipjanit.

II. Ndarja e mjeteve të cekura në pikën I të këtij Vendimi bëhet konform dispozitave të Marrëveshjes së cekur duke u bazuar në Raportin mbi arsyeshmërinë e shpenzimeve për përfitues, Listës së përfituesve në Komunën e Lipjanit për masën e vetëpunësimit (grante) në kuadër të projektit SUREP (Kthimi i qëndrueshëm i personave të riatdhesuar përmes Riintegritimit Socio-Ekonomik) si dhe Kërkesës për bashkëfinancim të granteve me 30%.

III. Shuma e mjeteve të cekura në pikën I të këtij Vendimi do të ndahet nga buxheti i Komunës- kategoria ekonomike e subvencioneve të planifikuara për Drejtoratin për Bujqësi , Pylltari dhe Zhvillim Rural .

IV.Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Drejtorati për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

V. Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës

15Nr. 120-174577

Lipjan, më 10.09.2021

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

